

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik “A.SH. Engineering” shpk  
**Adresa:** Rruga "Grigor Gjirokastriti", ish Fusha e Aviacionit, Ndërtesa 12, Kati i Parë,  
Njësia Administrative Nr.7, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: **“Procedurë e hapur e thjeshtuar”**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-89739-12-05-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Loti II: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i Emergjencës Civile, Ura e Gurrës dhe muret mbajtëse, fshati Qinam, Njësia Administrative Zall-Herr”.****Fondi limit: 72,490** (shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.**Burimi i financimit:** *Të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2023*, miratuar me VKB Nr.82, datë 20.07.2023, për disa ndryshime në VKB Nr.126, datë 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023”.**Kohëzgjatja e kontratës:** 16 (gjashtëmbëdhjetë) javë kalendarike.**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 18.12.2023 , ora 10:00**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike datë 11.12.2023, Nr.100

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim 

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “NOVATECH STUDIO” shpk** NUIS L01717030CVlera e ofertës = **57,154.66** (pesëdhjetë e shtatë e njëqind e pesëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.**2. Operatori ekonomik “A.SH. Engineering” shpk** NUIS L31617003FVlera e ofertës = **59,100** (pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind) lekë pa TVSH.

**3. Operatori ekonomik “HYDRO-ENG CONSULTING” shpk** NUIS M11417503F

Vlera e ofertës = **60,492** (gjashtëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

**4. Operatori ekonomik “PROJECT DALUZ 2019” shpk** NUIS L92112031B

Vlera e ofertës = **66,913.87** (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë pikë tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**Operatori ekonomik “NOVATECH STUDIO” shpk** NUIS L01717030C

*Perkatësisht për arsyet e mëposhtëme:*

Operatori ekonomik “NOVATECH STUDIO” sh.p.k, nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në shtojca 8, Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta për kualifikim ku përcaktohet: "Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, pasi vlera e ofertës është më e ulët se vlera minimale e perlogaritur per kete procedurë prokurimi sipas VKM 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim".

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “A.SH. Engineering” shpk** me adrese Rruga "Grigor Gjirokastriti", ish Fusha e Aviacionit, Ndërtesa 12, Kati i Parë, Njësia Administrative Nr.7, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **59,100** (pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind) lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.